[Shqiptarja.com]

E diel 4 Gusht 2024 - Përditësimi i fundit 10:33

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKEL RECETA HOROSKOP DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

Flash Zgjedhjet në Himarë, KQZ: Morën pjesë 37.61% e qytetarëve me të drejtë vote, 3.8% më shumë se në 14 maj 2023

ZGJEDHJE NË HIMARË

POP 5

Çfarë po ndodhë sot me lajmet me të lexuara ka 5 minutat e fundit?

1 LIVE- Himara pret emrin e krytarit të s. derdzuhes kulisë në KZAZ e numërimit! 800 votues më shumë se zgjedhjet e kaluara

2 VIDEO/ Gjikuria shfaqet vetëm dhe i braktisur dhëm e votimit duke ngrënë byrek, sorjë ekel politik krah tij

3 Mero Baze: Të gjithë ata që tradituan Petro Ganurnë

4 Pas dy vitesh lidhje, Kendall Jenner ndahet nga kaukëboliani i njohur

5 Arben Meçe: Klima ekstremizëta në Himarë nuk ddërl fare në vëtmendje të opinionit në Greqi

Kronikë

Terrorizuan Shkodrën duke qëlluar me armë në ajër, arrestohet Viktor Marku e 2 kushërinjtë e tij! Në 2020 u prangos për vrasjen e Hekuran Billës, por u la i lirë

Të shtëna me armë zjarri ka patur mbrëmjen e djeshme në Shkodër. Viktor Marku është personi që qëlloi, ndërsa ka qenë i dyshuar për vrasjen e Hekuran Billës në Tiranë

Viktor Marku dhe makina me të cilën lëvizte me dy kushërinjtë

Redaksia
3 Gusht, 09:21 | **Përditësimi: 3 Gusht, 20:32**

Share

SHKODËR- Të shtëna me armë zjarri ka pasur në orët e para të mëngjesit të sotëm *(3 gusht 2024)*, në afërsi të bustit të Prekë Calit në Shkodër. Viktor Marku është personi që qëlloi në ajër me armë.

Përveç Markut, u arrestuan dhe të dy persona të tjerë, dy djemtë e xhaxhait të tij, vëllezër mes tyre, Ndok dhe Lekë Marku. Në një automjet tip BMW është gjetur një gëzhojë arme me të cilën dyshohet se është qëlluar.

Policia informoi pasdite se kanë qëlluar në ajër në gjëndje të dehur.

LEXO EDHE:
'Veri Jug' - Fshati Ragam në stinën e verës

Marku ka qenë i dyshuar për vrasjen e Hekuran Billës në Tiranë. Ai ***u lirua për mungesë provash*** nga Gjykata e Tiranës ndërsa mbrëmjen e djeshme ka qëlluar në drejtim të personave që u konfliktua, por fatmirësisht nuk pati të lënduar.

Vrasja e Hekuran Billës

Viktor Marku dhe nipi i tij Sebastain Mali u arrestuan për atentatin e vitit 2020 në Komunën e Parisit në Tiranë, ku mbeti i vrarë Hekuran Billa. Mali e Marku u prangosën pas dyshimeve se e nxorën në pritë Billën me një vajzë. Kjo e fundit ishte infiltruar nga hasmi për ta nxjerrë biznesmenin në pritë. Fillimisht në dëshminë e saj ajo u shpreh se ishte paguar nga Viktor Marku, për t'i qëndruar pranë Billës, por më pas përpara prokurorëve ka mohuar kategorikisht përfshirjen e saj në këtë vrasje, teksa ka hedhur poshtë dhe zëirat se ajo ishte paguar për të nxjerrë në pritë viktimën. ***Hekuran Billa*** ishte në hasmëri me Viktor Markun, pasi në vitin 2006 ka marrë pjesë në vrasjen e vëllait, Pal Marku në Angli.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 17:56

Shkodër/ Policia jep informacion për arrestimin e Viktor Markut! Në pranga dhe 2 kushërinjtë e tij, vëllezër

Viktor Marku, foto arkiv

Shkodër- Policia e Shkodrës arrestoi Viktor Markun, dhe vëllezërit Ndok dhe Lekë Marku që ishin kushërinjtë e tij i autorë të të shtënave me armë në ajër që terrorizuan qytetin në orët e para të mëngjesit të sotëm (3 gusht 2024), në afërsi të bustit të Prekë Calit në Shkodër, sheshi që mban të njëjtin emër.

Policia thotë se të tre kanë qëlluar në gjëndje të dehur ndërkohë në mëngjes u mësua se të shtënat kanë ndodhur pas një konflikti me disa persona.

> *Në vijim të veprimeve hetimore, specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Shkodër bënë arrestimin e shtetasve të shoqëruar, të dyshuar si autorë të ngjarjes, konkretisht shtetasit: Viktor Marku, 38 vjeç, person me precedent kriminal në fushën e krimeve kundër personit dhe të vëllezërve Ndok Marku, 48 vjeç e Lekë Marku, 35 vjeç, të tre banues në Shkodër. Nga hetimet e kryera në bashkëpunim me Prokurorinë, dyshohet se këta shtetas, në gjëndje të dehur kanë qëlluar me armë zjarri në ajër, informoi sot policia e Shkodrës.*

Në 2020 Marku u arrestua u dyshua se kishte marrë pjesë në atentatin ndaj Sebastian Malit në Komunën e Parisit në Tiranës por më pas u la i lirë për mungesë provash.

S.G/Shqiptarja.com

Share

SI.E./S.G/Shqiptarja.com

TAG: Lekë Marku | Ndok marku | Hekuran Billa | viktor marku | Shkodër

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si ju duket turizmi këtë sezon, krahasuar me një vit më parë?

Më mirë | Më keq | Njëlloj

Lajme të tjera

Shkodër, i moshuari humbet kontrollin e motorit dhe del nga ruga, përfundon i plagosur në spital
4 Gusht, 12:36



Shkodër/ Policia jep informacion për arrestimin e Viktor Markut! Në pranga dhe 2 kushërinjtë e tij, vëllezër
3 Gusht, 17:56

Makina përplas të miturën në Shkodër
3 Gusht, 14:12

Shkodër/ Me helikopter për në Temal për të djegur 12 mijë bimë kanabisi! Shikoni videon e operacionit
2 Gusht, 11:24

Futbolli shqiptar dështim në Evropë, Egnatia dhe Partizani eliminohen nga Conference League
1 Gusht, 21:58

Shkodër/Asgjësohen 8839 bimë kanabis, policia në kërkim të autorëve
1 Gusht, 13:19

Shkodër/ Ndezi zjarr dhe dogji stallën e bagëtive, në pranga 64-vjeçari (EMRI)
1 Gusht, 11:42

Menaxhimi i mbetjeve, dështojnë bashkitë Vlorë, Shkodër, Durrës dhe Korçë! KLSH: Tymi i plehrave në Vlorë rrezikon jetën e banorëve

Eliza Gjediku

31 Korrik, 16:01

Tritol lokalit në Velipojë, policia në kërkim të autorit! Ishte dhënë me qira, zbardhet dëshmia e pronarit
30 Korrik, 07:05

Zjarret në vend/ 8 vatra aktive, vijojnë flakët në Malin e Shëngjinit e Vau i Dejës! Drejt përmirësimit situata tek vendgrumbullimi i mbetjeve Vlorë
29 Korrik, 11:08

Malësi e Madhe/ I vuri zjarrin shkurreve, dogji pyllin në fshatin Vukpalaj, arrestohet 43-vjeçari (EMRI)
29 Korrik, 08:44

Velipojë/ Lëndohet një 8 vjeçare gjatë lundrimit në skaf me familjen, dërgohet në spital! Drejtuesi i mjetit shoqërohet në Komisariat
28 Korrik, 19:53

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gjithçka

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje